

IRMA BILALI

**ETËHEM HAXHIADEMI,
FIGURA FEMËRORE NË VEPRA**

Një vend të veçantë në historiografinë letrare shqipe zë letërsia e gjysmës së parë të shekullit XX dhe autorët që ishin pjesë e saj. Autori Etëhem Haxhiademi shfaqet si personalitet letrar në mesin e viteve '30 dhe ndonëse do të provonte mjeshtërinë e tij në disa fusha të krijimtarisë letrare si dhe në publicistikë, ai mbetet një zë përfaqësues i dramatikës shqiptare në fillesat e saj. Drama shqipe si gjini letrare zë një vend të veçantë, ndonëse minor, në lëmin e gjithë letërsisë sonë. Në këto vite drama shqipe dhe në mënyrë specifike drama dhe tragjedia klasike vijjnë si risi në arealin kulturor shqiptar. Parë nga perspektiva e sotme, vëmë re se veprat dramatike të autorit elbasanas përcjellin përvoja e tematika me shumë interes në shumë aspekte e veçanërisht në lidhje me konceptimin e figurës njerëzore dhe lirinë e shprehjes së individit. Në këto tekste letrare ekziston një shprehje tjetër e mendimit, e fantazisë e njohjes së botës.

Etëhem Haxhiademi siç e quan Vangjel Koça është tipi më përfaqësues në poezinë dramatike të brezit të viteve '900, i cili duket të ketë rënë në dashuri me helenizmin klasik.¹ Po kështu edhe Robert Elsie, pohon për Haxhiademin *se formimi i thellë evropian perëndimor i tij gjeti shprehje më të plotë në tragjeditë klasike sipas modeleve greke e latine.*²

¹ Vangjel Koça, "Etëhem Haxhiademi, dramaturg humanist", *Mendimi kritik letrar-shqiptar (1870-1945)*, Botime Plejad, Tiranë, 2004, f. 105.

² <http://www.balkanweb.com/site/ethem-haxhiademi-doreskrimet-dhe-fotot-e-shkrimtarit-te-ndaluar/>

Gjithashtu albanologu Elsie thekson *se dramat e shkruara nga Haxhiademi shkonin përtej dramave bajate me tema kombëtare dhe shfrimeve sentimentale të periudhës së Rilindjes së vonë*.³

Etëhem Haxhiademi me krijimtarinë e tij dramatike vjen pranë shkrimtarëve neoklasikë si Pjer Kornej dhe Zhan Rasin (kemi parasysh tematikën, personazhet, poezinë dramatike, strukturën e kompozicionin) të cilësuar si shkrimtarë neoklasikë, veprat e të cilëve parimisht duhet të kenë një qëllim didaktik dhe moralizues. Ata besuan se përmes veprave letrare, lexuesit mund të edukonin veten dhe të ndjeheshin pjesë e një arritjeje më të madhe.

Etëhem Haxhiademi është gjithashtu pinjoll i shquar i shquar i shpirtit poetik të traditës kulturore të vendlindjes të ngjizur në personalitetin e tij, që ai e percepton në detaje, ndaj dhe sintagma poetike është unike. Sintagma e rrëfimit dramatik të Haxhiademit estetkisht përvijohet në shumë dimensione. Autori solli tragjedinë në vargje, model i përdorur nga autorët romantikë, e cila përcjell ndjesi e reflektime me një gjuhë të zgjedhur poetike. Ndikimin e shkollës romantike tek pjesët e Etëhem Haxhiademit, studiuesi i dramaturgjisë shqiptare Josif Papagjoni e sheh në parapëlqimin e *hapësirave ekzotike të virgjëra, të egra, me peisazhet e bukur apo të ashpër, me mjediset e trilluara, gati si në mite, legjenda e përralla*.⁴

Këto mjedisë kanë ndikuar edhe në modelimin e personazheve veçanërisht ato femërore në përpjekje për të ndërthurur mjedisin gjeografik dhe atë social.

Haxhiademi së bashku me Fan Nolin, Gj. Fishtë, Çajupin të cilët gjithashtu kanë lëvruar gjininë dramatike në krijimtarinë e

³ Robert Elsie, *Letërsia shqipe, Një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë, 2005, f. 159.

⁴ Josif Papagjoni, *Kumti që vjen nga trashëgimia teatrore*, Sh. B. Shkenca, Tiranë 1999, f. 203.

tyre, konsiderohen si autorë të shquar të kësaj periudhe që vijnë prej kulturave të ndërthurura dhe formimeve të skajshme dhe sjellin në letërsinë tonë drama klasike me tematikë mitologjike, biblike e historike.

Tragjeditë e Haxhiademit janë në qendër të letërsisë dhe të trupave teatrore shqiptare të viteve '20-'30. Pas luftës, me vendosjen e sistemit totalitar, autori dënohet dhe veprat censurohen.

Sot ato trajtohen e vlerësohen si një fazë me rëndësi e zhvillimit të gjinisë klasike dramatike si tragjedia. Thjeshtësia dhe qartësia e stilit të autorit ndihmojnë të kuptojmë konfliktet e një të tashmeje të vazhduar. Haxhiademi si një mbrojtës i lirisë përcjell në vepra një valencë shumëpërfshirëse të stilit për të cilën vlen sugjerimi ndaj lexuesit edhe në ditët e sotme.

Vërtet letërsia shqipe nuk ka arritur të krijojë figura femërore që të mbeten simbol i caktuar apo mite letrare si Helena, Medea, Beatrice, Zhulieta. E megjithatë ajo ka arritur të konfigurojë figura femërore mjaft të ndjera e të lartësuar si Tanusha, motra e Gjergj Elez Alisë, Jerina, Tringa, Bardha e Temalit, Diloca, e mjaft figura të tjera që i mbeten letërsisë dhe jetës sociale e kulturore. Në këto figura mund të ketë kontradikta, por ato i japin jetë veprës, janë personazhe të pëlqyeshme, ndoshta jo të plota. Jepet ideali i feminitetit të thjeshtë: si ia dalin ato femra të mbijetojnë në një mjedis tejet të vështirë historik dhe social.

Ndonëse roli i gruas në shoqërinë e kohës kur jetoi e shkroi E. Haxhiademi është pothuaj i padukshëm, në veprat letrare e veçanërisht në ato dramatike, figura femërore është mjaft e rëndësishme. Ajo ka një rol kyç në zhvillimin e ngjarjeve.

Vepra dramatike e Haxhiademit duke u konceptuar si tragjedi mbi temat e mëdha të jetës, mbi ndjenjat, mbi ngjarjet e luftës dhe paqes nuk mund të evitojë rolin strategjik të gruas (në pozicionet si grua, si nënë apo si bijë). Në tragjeditë e shkruara ka

një larmi konfliktesh siç jeta i ka në të vërtetë me kontradiktat e shumta të saj.

Trashëgimia mitologjike, biblike, historike dhe artistike duket të ketë qenë ndikuese në produktin letrar të shkrimtarit E. Haxhiademi. Figurat mitologjike dalin në dramaturgjinë e tij, por edhe në vargjet poetike si nimfat, Najadat e Driadat që lahen në zaje të Shkumbinit e zani u shtohet siç shprehet poeti. Po ashtu gjejnë vend në poezi edhe figurat historike e kulturore të rëndësishme siç është Naim Frashëri, të cilit i kushtohet poezi në nderim të përkujtimit të figurës madhore të tij pas largimit nga jeta. Këto poezi të gjendura në vëllimin “Lyra”, përshkohen në linja paralele me figurat mitologjike rreth të cilave shkruhen disa nga tragjeditë si Ulisi, Akili, e në tragjedi të tjera shfaqen figurat historike të Pirros, Aleksandrit e Skënderbeut. Autori i ka gjetur aty një materie më komplekse, epike e dramatike.

Sipas teoricienëve Wellesk dhe Worren: “Të thuash se shkrimtari ka nevojë për mitin, është shenjë e nevojës që ai ndien për t’u bashkuar me shoqërinë, për të gjetur vendin e vet në shoqëri, për t’u integruar në të”.⁵ Haxhiademi ishte një figurë e rëndësishme për shoqërinë e kohës, ai ishte pjesë e grupit të studentëve të Gracit të fillimviteve ’30 me një kontribut të rëndësishëm në zhvillimet politike, kulturore e sociale.

Tematika në të cilën është mbështetur i ka shërbyer si burim energjie për t’u përcjellë si kënaqësi estetike. Vepra e Haxhiademit, është një sintetizim i konceptit ideor dhe i drejtimit letrar në të cilin ai u përfshi. Ajo është shkruar me një stil elegant dhe të kuar, të ngjashëm me stilin e shkrimtarëve europianë të viteve ’900.

Në tragjeditë klasike të Haxhiademit duket një vëmendje e veçantë ndaj figurës femërore në përgjithësi dhe sidomos atyre grave që kanë pasur një rol të caktuar në historinë e mendimit njerëzor në kontekste të caktuara. Megjithëse drama e tij vjen në

⁵ Worren Wellesk, *Teoria e letërsisë*, Onufri, Tiranë, 2007, f. 198.

vazhdën e tragjediive klasike, në modelin e atyre greke, tragjeditë e Haxhiademit nuk kanë si titull emrat e heroinave femërore sikundër ndodhte tek Eskili, Sofokliu e Euripidi, por personazhet femërore vijnë si heroina që thyejnë mitet. Sigurisht ato nuk janë personazhe protagoniste. Kanë një rol dytësor, por të rëndësishëm.

Tek Haxhiademi femrat zgjidhen sipas konceptit të dënimit të Platonit për të paraqitur dhimbjen ekstreme dhe pasionin ekstrem. Në tragjedi gratë kanë rolin e tyre sikundër nuk ndodhte në jetën e përditshme e as në historinë e kohës që përcjell drama. Personazhet gra me performancën e tyre i përçojnë lexuesit e shikuesit në skenë përjetime emocionale. Kështu autori mbështet teorinë e Aristotelit i cili thotë se zhvillimi i personazheve të tragjedisë nuk është i jashtëm, por i brendshëm.⁶

Penelopa në tragjedinë “Uliksi” është një grua besnike sipas mitit, në tragjedinë e Haxhiademit vijon të jetë e tillë deri në aktin e katërt e të pestë kur e humbet besnikërinë pasi ka marrë vesh se Odiseu e ka tradhtuar dhe ka sjellë në jetë një djalë me Circen. Shkelja e besnikërisë mund të përlligjet në linjën e psikologjisë femërore. Ajo e ruajti nderin deri sa besonte që Odiseu ruante nderin e saj. Kështu edhe ajo kthehet në viktimë të fatit.

Tek tragjedia “Aleksandri” gjithashtu paraqiten *se si dy gra shemra me një burr ku e çojnë një familje dhe në ç’fatkeqsi*⁷. Vërtet tragjedia ka titullin “Aleksandri”, por duket se rolin kryesor e ka Olimpiada, e ëma e Aleksandrit e cila vret Kleopatren e nxitur nga pasioni i verbër i pushtetit të cilin ia trashëgon të birit.

Olimpiada është ambicioze dhe hakmarrëse. Aleksandri është më shumë lodër në duart e së ëmës, e cila vendos fatin e tij

⁶ Aristoteli, *Poetika*, Çabej, Tiranë, 2006, f. 41.

⁷ <https://gazetadielli.com/me-poetin-dramaturg-ethem-haxhiademi/>

dhe i jep pushtetin.⁸ Olimpiada vret Aleksandrin në skenë dhe këtu autori ka kapërcyer linjën e tragjedisë klasike mitologjike duke e konceptuar “Alkesandrin” si tragjedi historike.⁹

Në tragjedinë “Abeli” familja e Adamit dhe Evës, familja e parë njerëzore që konsiderohet edhe si “familja e shenjtë” përcjell në dukje harmoninë familjare. Por e gjitha kjo shumë shpejt do të kthehet në një shkatërrim moral. Kjo tragjedi si dhe tragjedia “Diomedi” *cilësohen si vepra ku subjekti lidhet me fatin tragjik që shoqëron pasionin e dashurisë dhe aktin e vëllavrasjes*.¹⁰ Kaini vë në dyshim përsosmërinë e cila për të është vetëm një iluzion. Abeli është natyrë e dashur dhe ai arrin përherë të fitojë zemrat e prindërve. Kaini i mendon fjalët e Abelit si të shtirura duke mos besuar se ekziston një dashuri kaq e madhe. Xhelozia që e pushton e çon të ndërmarrë aktin e vrasjes. E gjithë drama ngrihet mbi një veprim tragjik me shumë tragjizëm në brendësi, vrasja dhe akoma më tepër vëllavrasja.¹¹ Vdekja e Abelit është jo vetëm vdekja, por vdekja e parë në historinë e njerëzimit dhe bota njeh kështu vëllavrasjen si tragjedi që do ta shoqërojë qenien njerëzore në mijërvjeçarë. Autori lë të kuptojë që ky është një mallkim, një mallkim i zi që lejon vijimin e konfliktit njerëzor që kosit në breza të tërë jetë njerëzish në familje e përtej saj. Tragjedia është një apoteozë për jetën njerëzore dhe të drejtën e saj.

Në gjithë këtë situatë tragjike ku Kaini është dyfish tragjik pasi ai mohohet dhe vetëm akuzohet nga prindërit, Eva po ashtu si dhe personazhet e tjera femërore në dramën e tjera është viktimë e fatit.

⁸ Vangjel Koça, “Etëhem Haxhiademi, dramaturg humanist”, *Mendimi kritik letrar-shqiptar (1870-1945)*, Botime Plejad, Tiranë, 2004, f. 111.

⁹ *Po aty*, f. 112.

¹⁰ Vjollca Spaho; Valbona Kalo; Migena Kapllani; Marsela Neni; Merita Balliçi, *Letërsia 10*, Botime Filara, Tiranë, 2016, f. 237.

¹¹ Sabri Hamiti; Dhurata Shehri; Ardian Marashi, *Letërsia 10*, Botime Albas, 2017, f. 210.

Eva si nënë përpiqet që zbutë mërinë dhe inatin e Kainit ndaj të vëllait. Ajo e para fillon të kuptojë situatën e Kainit dhe parandien fatkeqësinë. Ajo kërkon të nderë tek Kaini dashurinë për të vëllanë:

Eva (Kainit)

Të thash se na nuk kena ma ç'të presim / Me sot me nesër na o bir do vdesim.

Por vetëm ju të dy do t'çoni jetë/ prandaj lypset të duhi me të vërtetë.

Në ligjërimin e Evës mungon mallkimi, sentencat që dëshirojnë dënimin e Kainit përjetësisht vendosen në diskursin e Adamit. Eva dënohet jo vetëm sepse nuk realizuar si duhet detyrën e prindit në edukimin familjar, por pësimi i tragjedisë vjen edhe për të ndëshkuar mëkatin fillestar të kryer bashkë me Adamin të cilët sipas Biblës kishin prekur drurin e njohjes të ndaluar nga Hyji.¹²

Kështu vepra merr tipare të tregimit didaktik nga thëniet moralizuese në gojën e personazheve. Në këtë dramë zbulohen raportet familjare, burrë-grua, nënë-bij, vëlla-vëlla. Kërkimi i një jete humane duhet të vijë nga edukimi, e këtë e sjell si mesazh autori. E thënë me fjalët e autorit në parathënien e veprës: *Me këtë pjesë, në të cilën luajnë njerzit ma të parë të botës, desha të ngas një plagë shoqnore. Dashnija vllaznore nuk rrjeth nga afërimi i gjakut, sikundër besojnë të gjithë, por mbas pikëpamjes s'ime nga edukata e prindërvet.*¹³ Tragjedia “Abeli” është vepër studimi në tekstet e letërsisë së shkollës së mesme, në klasën e 10 në studimin e autorëve dhe teksteve të gjinisë dramatike.

Në tragjedinë “Akili” e shkruar në vitin 1926 e dyta në radhë pas tragjedisë “Ulisi”, siç është shprehur edhe vetë poeti, *Shpirti i tragjedisë “Akili” asht ahmarrja. Çdo njeri qi vret, sado*

¹² Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, Botime Albas, 2003, f. 207.

¹³ Sabri Hamiti; Dhurata Shehri; Ardian Marashi, *Letërsia 10*, Botime Albas, 2017, f. 210.

*i fortë me qenë në fund do ta pësojë.*¹⁴ Poliksena në dramën “Akili” është një grua-viktimë. Ajo përdoret dhe tradhohet nga vetë familja e vet: *O at, s’di si të them për këtë martesë/ Më duket si pa shije dhe e zezë*¹⁵, shprehet ajo para martese. Në fund pas aktit të vrasjes së Akilit nga Priami, e dëshpëruar dhe e zhgënjyer ajo i kthehet të atit duke e gjykuar: *Un’kët e dija, prandaj s’kisha dëshirë këtu të vinja/E vrat, por jo burrnisht, me pabesi/ E vrat dhe kjo për ty asht poshtërti. Kunorës mbretmore që mban mbi kry.*

Figura e Poliksenës e cila vjen nga mitologjia ridimensionohet në kufijtë e një nostalgjie që mjaltin dhe zeherin i ka bashkë duke përcjellë dhimbjet prej femre. Në këtë këndvështrim ajo krijon analogji me personazhin e Dalilës në dramën “Izrailitë dhe Filistinë” të Fan Nolit. Duke marrë shkas edhe nga koha kur shkruhen tragjeditë dhe nga referencat tematike e strukturat neoklasike, duket se subjekti mitologjik ishte i preferuar nga dramaturgët e viteve ’30 të dramës shqipe, ndoshta duke i gjetur të përshtatshme për kohën dhe zhvillimet në shoqërinë shqiptare e në marrëdhëniet me fqinjët. Në këtë paralelizëm kemi parasysh edhe faktin që të dy autorët i përkasin edhe fushës së politikës së kohës.

Tragjedia “Skënderbeu” u shkrua më 1935. Autori shprehet në parathënie se kjo temë ishte marrë prej historisë kombëtare (ma të këthellët), pas tragjedive të mëparshme kushtuar figurave me zë të historisë botërore si “Ulisi”, “Akili”, “Aleksandri”, “Pirro”. Këtë zgjedhje dramaturgu e arsyeton me argumentin se popullit tonë i pëlqejnë temat kombëtare.¹⁶

Zanfina ka një rol strategjik në vepër. Ajo është nxitëse e luftërave dhe e tradhtisë si pasojë e urrejtjes dhe e hakmarrjes. Drama e dashurisë së humbur e shtyn Zanfinën drejt hakmarrjes.

¹⁴ <https://gazetadielli.com/me-poetin-dramaturg-ethem-haxhiademi/>

¹⁵ Etëhem Haxhiademi, *Akili, botim i cituar*, f. 53.

¹⁶ Etëhem Haxhiademi, *Skënderbeu*, 1935, f. 1.

Nga Barleti dëshmohej se Skënderbeu lidhi në martesë të motrën Mamicën me Karl Topinë, i cili më parë kishte qenë i martuar me vetë Zanfinën.

E pesta Zonja Mamica u bë grua e Muzak Topisë, por që Zot Skënderbeu e ndau nga gruaja e parë që quhej Zanfina ose ndryshe Suina Muzaka dhe i dha Zonjën Mamicë, të motrën”¹⁷

Këtë situatë ka shfrytëzuar Haxhiademi në tragjeditë e tij ku Zanfina shtyn Moisiun e më pas Hamzain drejt tradhtisë në përpjekjen e stisur për të zënë vendin që i takon në drejtimin e mbretërisë së Kastriotëve. Përpjekja e Moisiut për të vendosur paqe me veten pas aktit të tradhtisë është vënë nga autori në anën e Skënderbeut i cili i mundëson faljen. “Skënderbeu” i Haxhiademit është një protagonist që jep indikacione të ndërlihdhjes me tiparet që janë karakteristikë e disa profetëve në besime të ndryshme duke i dhënë virtytet si falja dhe besimi tek njerëzit. Personazhi i Skënderbeut ka karakter epik. Atmosfera nacionale krijohet nga larmia e të gjitha figurave që bëjnë pjesë në dramë.

Nëse Moisiu arrin të rehabilitojë figurën e tij, Zanfina nuk gjen paqe. Atë e shtyn urrejtja, “*Ay s’asht burri qi un e gjeta vetë/ për t’kalumun këtë të zezën jetë/ A e pëlqeu me syt e vet im atë/ Por ju o mbret u shkaktuet e ma dhatë.*”¹⁸ Hakmarrja drejt veprimeve të tjera dhe kur e gjen veten të pashpresë arrin aktin fatal. Përballë Zanfinës vendoset Donika. Në një numër ta madh dialogësh paraqiten të dyja tek shkëmbejnë replika në lidhje me gjendjen në të cilën ndodhet shteti i Arbërve. Donika është figurë statike, syri vëzhgues, dyshues dhe paralajmërues për Skënderbeun. Duke hetuar vizualitetin dhe performancën e dy grave që vijjnë nëpërmes dialogëve e monologëve poetikë të autorit, na vjen një përfytyrim i gjallë i imazhit, i gjendjes emocionale dhe i kohës kur ato jetojnë. *Aty ku mbaron rivaliteti i*

¹⁷ Marin Barleti, *Histori e Skënderbeut*, Infbotues, Tiranë, 2005, f. 25.

¹⁸ Etëhem Haxhiademi, *Skënderbeu, botim i cituar*, 1935, f. 50.

grave, nis problemi i ri për prijsin - reflekton S. Hamiti në analizën për fragmentin e shkëputur nga drama ku Skënderbeu gjykon mbi situatën e ndodhur pas tradhtisë së Hamzait.¹⁹

Tipari themelor i vizualitetit është veprimi dramatik pa të cilin nuk mund të flitet për lëvizje të mendimit dhe këto shfaqen në dialogët e njëpasnjëshëm të Zanfinës. Në zhvillimin e personazhit dallojmë zbërthimin e kontradiktës së brendshme që bëhet shkas për konfliktet që ndodhin brenda në pallatin mbretëror. Pasioni, dhimbja femërore, bëhet kështu model edhe për dhimbjen njerëzore. Zanfina shkon drejt aktit fatal të vetëvrasjes.

Kontrasti tragjik në tragjeditë e autorit lind nga kundërvënia e dy tipeve të personazheve të konceptuara në dimensionin e tyre mitik e historik. Nga njëra anë qëndrojnë personazhet si subjekte të kthesave të forta historike e nga ana tjetër njerëz me ndjesi të forta e shpirtra të trazuar.

Në tragjeditë e E. Haxhiademit duket sikur ka një vizion pesimist për historinë njerëzore, për sa kohë duket sikur ajo është dominuar nga e keqja dhe kapërcimi i saj duhet kërkuar në stabilizimin e raporteve njerëzore, veçanërisht të shoqërisë shqiptare që ishte në krizë të thellë ekzistenciale.

Karakteret femërore në tragjedinë e E. Haxhiademit janë koherente dhe shpeshherë ashtu si në tragjedinë greke ato shërbejnë për të zbuluar tek burrat gjendje emotive që u janë ndaluar në modelin e sjelljes femërore. Kjo paraqitje, siç shprehet edhe studiuesi Ali Xhiku, lidhet me parimin klasicist sipas të cilit njeriu nuk është kurrë as krejt i mirë, as krejt i keq deri në fund. *Pas një gabimi ose dobësie ai vuan rrjedhoja të rënda, që s'varen më prej tij e që nuk i meriton të gjitha.*²⁰

¹⁹ Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, Botimet Albas, f. 273.

²⁰ Ali Xhiku, *Letërsia shqipe si polifoni*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 281.

Në paraqitjen letrare dhe teatrale të grave në botën antike është lidhja me familjen me gjithë kufizimet konvencionale të traditës.

Gruaja mbron familjen dhe sakrifikon veten për familjen, veçanërisht meshkujt e familjes.

Konflikti tragjik dhe rezultatet e tij të pashmangshme, të trishtueshme nxiten nga urrejtja e ndërsjellë dhe nga mosmarrëveshjet që grishin brendësinë psikologjike të individëve dhe shpesh janë gratë që e paraqesin më së miri këtë kontrast të brendshëm.

Brenda problemeve, përjetimeve, anktheve të personazheve integrohet identiteti kombëtar si shprehje e artistike e mesazhit universal. Vetë përshkrimi i figurave femërore vjen në trajtën e kërkimit për bukurinë shqiptare të tyre. Ligjërimi i tyre mbart emocione nëpërmjet dialogëve dramatikë ku duket gjuha e një stili të lartë, të zgjedhur, të mbështetur në frazeologjinë popullore e shprehësi artistike që pasurojnë diskursin dramatik. Studiuesi i dramës dhe teatrit shqip Josif Papagjoni thekson se *çdo teatër duhet të dëshirojë e të synojë dramaturgjinë kombëtare si materien e shfaqjes. Pa dramaturgjinë kombëtare do të dukej i gjymtë e i pakuptimtë synimi për frymë, për karakter, për stil kombëtar, sado të shndritshëm të jenë interpretimi aktorial, konceptimi regjisorial, gjetja skenografike.*²¹

Në këtë kuadër, theksojmë se mjaft të vlefshme e konsideron krijimtarinë e autorit Haxhiademi Robert Elsie, kur këshillon se *për të gjetur dramën më të mira të paraluftës duhet t'i kthejmë sytë pjesërisht tek pjesët klasike të E. Haxhiademit.*²²

Veprat e këtij autori, e në mënyrë më specifike drama hyn në komunikimin e sotëm estetik me lexuesin me ambicien për të

²¹ Josif Papagjoni, *Kumti që vjen nga trashëgimia teatrore*, Sh. B. Shkenca, Tiranë, 1999, f. 50.

²² Robert Elsie, *Letërsia shqipe, Një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë, 2005, f. 159.

kumtuar jetën në themel të veprës si materie estetike. Ajo vjen si një kontribut original në përpjekje për të shpërfaqur një shumësi konceptimesh nëpërmjet një stili tërheqës që përcjell portrete, imazhe e ndjesi të shumëfishta për lexuesin dhe shikuesin në skenë.

BIBLIOGRAFI

Materiale nga interneti

<https://gazetadielli.com/me-poetin-dramaturg-ethem-haxhiademi/>
<http://www.balkanweb.com/site/ethem-haxhiademi-doreskrimet-dhe-fotot-e-shkrimtarit-te-ndaluar>

Materiale të botuara

Vepra e autorit

Haxhiademi, Etëhem, *Skënderbeu*, Tiranë, 1935.

Haxhiademi, Etëhem, *Akili*, Vjenë, 1926.

Haxhiademi, Etëhem, *Lyra*, Elbasan, 1937.

Studime

Elsie, Robert, *Letërsia shqipe, Një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë, 2005

Hamiti, Sabri, *Letërsia moderne shqipe*, Albas, 2003.

Hamiti, Sabri; Shehri, Dhurata, Marashi Ardian, *Letërsia 10*, Albas, Tiranë, 2017.

Hamiti, Sabri; Shehri, Dhurata; Marashi, Ardian, *Letërsia 10*, Albas, Tiranë, 2017.

Koça, Vangjel, “Ethem Haxhiademi, dramaturg humanist”, *Mendimi kritik letrar-shqiptar (1870-1945)*, Botime Plejad, Tiranë, 2004.

Barleti, Marin, *Histori e Skënderbeut*, Infbotues, Tiranë, 2005.

Papagjoni, Josif, *Kumti që vjen nga trashëgimia teatrore*, Sh. B. Shkenca, Tiranë, 1999.

Spaho, Vjollca; Kalo, Valbona; Kapllani, Migena; Neni, Marsela; Balliçi, Merita, *Letërsia 10*, Filara, Tiranë, 2016.

Wellek R., Worren, *Teoria e letërsisë*, Botime Onufri, Tiranë, 2007.

Xhiku, Ali, *Letërsia shqipe si polifoni*, Botime Dituria, Tiranë, 2004.

